



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:156561

Datë: 28.04.2021

Numri i dokumentit: 01739774

P.nr.1023/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Vjollca Buzhala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Nezaj, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.D., nga Prizreni, për shkak veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1994-12/20 të datës 12.11.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit- Petrit Kryeziu, i akuzuari, me datë 29.03.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

E.D., nga i ati, e ëma, e vajzërisë,e lindur më datën në, me banim në rrugën “.....”p.n, Prizren, e martuar, amvise, ka të kryer 5 vite të shkollës fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit i lëshuar nga MPB-ja ne Prishtinë, ashtalike, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Se me datë 28.08.2020, rreth orës 11:00, në Lagjen -Prizren, saktësisht në hapësirat e jashtme (oborrin) e ish restorantit “.....”, i cili gjendet në rrugën “.....”, pronë e të dëmtuarit V.G., e pandehura në bashkëveprim me vajzën e saj të mitur B.b., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër, i marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit, ashtu që e pandehura ditën kritike, duke shfrytëzuar momentin e volitshëm hynë në oborrin e pllacit dhe nga aty marrin gjësende të ndryshme dhe atë: një pompë hidrofiori, nëntë (9) copë elektronike të motorit të veturës, një (1) filtër traktori, nëntë (9) pjesë të vogla të ndryshme për veturë, tetë (8) alternator të veturës, një (1) ABS-pjesë për frenim, një (1) kompjuter të vogël për veturë, dy (2) shpata të motosharrës STHIL, dy (2) brisqe të kosës së barit, një (1) zingjir i ndryshkur, pesëmbëdhjetë (15) anglasera - pajisje për ndezjen e veturës, një (1) alternatorë i veturës dhe një karrocë dore ngjyrë e kaltër. Të gjitha këto gjësende i ngarkojnë në karrocë dore, të njëjta duke u larguar, vërehen nga i dëmtuari i cili më pas edhe i përcjell deri në hekurishten ”” ku edhe i dërgojnë, dhe pa hyrë në hekurishte ndalën nga i dëmtuari, i cili më pas i verifikon gjësendet dhe e njofton Policinë.

Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr.06/L074 të RK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 17, 40, 43,46,47,48 49 paragr.1, 69 , dhe neni 313 të KPRK-së si dhe nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **100 € (njëqind euro)**, të cilën shumë e akuzuara duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi, e nëse e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burgim, përkatësisht 15 ditë burgim.

DËNIMIN ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari mbrenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari V.G., nga fshati Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet gjyqësore të procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej 20 euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1994-12/20 të datës 12.11.2020, kundër të akuzuarës E.D., nga Prizreni, për shkak veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 (KPRK),

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin i akuzuari pasi që është deklaruar lidhje me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.1994-12/20 të datës 12.11.2020, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas kësaj aktakuze.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se me datë 28.08.2020, rreth orës 11:00, në Lagjen -Prizren, saktësisht në hapësirat e jashtme (oborrin) e ish restaurantit “.....”, i cili gjendet në rrugën “.....”, pronë e të dëmtuarit V.G., e pandehura në bashkëveprim me vajzën e saj të mitur B.b., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër, i marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit, ashtu që e pandehura ditën kritike, duke shfrytëzuar momentin e volitshëm hynë në oborrin e pllacit dhe nga atz marrin gjësende të ndryshme dhe atë: një pompë hidrofiori, nëntë (9) copë elektronike të motorit të veturës, një (1) filtër traktori, nëntë (9) pjesë të vogla të ndryshme për veturë, tetë (8) alternator të veturës, një (1) ABS-pjesë për frenim, një (1) kompjuter të vogël për veturë, dy (2) shpata të motosarrës STHIL, dy (2) brisqe të kosës së barit, një (1) zingjirë i ndryshkur, pesëmbëdhjetë (15) anglasera-paisje për ndezjen e veturës, një (1) alternatorë i veturës dhe një karrocë dore ngjyrë e kaltër. Të gjitha këto gjësende i ngarkojnë në karrocë dore, të njëjta duke u larguar, vërehen nga i dëmtuari i cili më pas edhe i përcjell deri në hekurishten “.....” ku edhe i dërgojnë, dhe pa hyrë në hekurishte ndalën nga i dëmtuari, i cili më pas i verifikon gjësendet dhe e njofton Policinë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarës E.D., në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilat akuzohet. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimit i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lart ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar pranimitin e fajësisë nga ana e tij, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit dhe se me këtë dënim të tillë të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në të ardhmen dënimi i tillë i shqiptuar do të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së., ndërsa vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë në pajtim me nenin 39 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2020:156561, 28.04.2021

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.